MARRËVESHJE ADMINISTRATIVE
PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES PËR SIGURIME SHOQËRORE NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në zbatim të nenit 22 të Marrëveshjes për Sigurime Shoqërore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, autoritetet kompetente të Shqipërisë dhe Kosovës, bien dakord si vijon:

PJESA E PARË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizime

a) Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, termi *"Marrëveshje"* nënkupton *Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për Sigurime Shoqërore.*
b) Termat e përdorur në këtë marrëveshje kanë të njëjtin kuptim si në nenin 1 të Marrëveshjes.

Neni 2
Agjencitë kompetente

Në zbatim të nenit 22 të Marrëveshjes, agjencitë kompetente janë:

a) për Kosovën:

1. Për të drejtën për pension kontributpagues të moshës, të drejtën për pension invalidor të punës dhe të drejtën për pension familjar, është:
   Divizioni i Pensioneve të Jashtme - Departamenti i Pensioneve, Prishtinë.
2. Për të drejtën për pension nga Fondi i Kursimeve Pensionale Individuale (shtylla e dytë), është:
   Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, Prishtinë.

b) për Shqipërinë:
Përfitimet në para për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe familjare, barrëlindjet, aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, është:
Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Tiranë.

Neni 3
Zyrat ndërlidhëse

Në zbatim të nenit 22 të Marrëveshjes, zyrat ndërlidhëse janë:

<u>Në Kosovë</u>:

1. Për të drejtën për pension kontributpagues të moshës, të drejtën për pension invalidor të punës, të drejtën për pension familjar, është:
   Divizioni i Pensioneve të Jashtme - Departamenti i Pensioneve, Prishtinë.
2. E drejta për pension nga Fondi i Kursimeve Pensionale Individuale (shtylla e dytë), është:
   Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, Prishtinë.

<u>Në Shqipëri:</u>

1. Përfitimet në para për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe familjare, barrëlindjet, aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, është:
   Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Tiranë.

Neni 4
Formularët dhe shkëmbimi elektronik i të dhënave

1. Agjencitë kompetente të dy shteteve kontraktuese përcaktojnë me mirëkuptim të dyanshëm formularët e nevojshëm për zbatimin e Marrëveshjes.

2. Me qëllim lehtësimin e zbatimit të marrëveshjes, zyrat ndërlidhëse mund të marrin masa për shkëmbim elektronik të të dhënave.

PJESA E DYTË

DISPOZITA PËR LEGJISLACIONIN E ZBATUESHËM

Neni 5
Çertifikata e mbulimit

1. Në rastet e parashikuara sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 6, dhe neneve 7 deri në 10 të Marrëveshjes, agjencia kompetente e shtetit kontraktues, të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, legjislacioni i të cilës do të zbatohet me kërkesë të punëdhënësit, personit të punësuar ose të vetëpunësuar dhe nëpunësit civil, duhet ta pajisë atë me një çertifikatë mbulimi. Çertifikata e mbulimit përmban periudhën e vlefshmërisë dhe sipas marrëveshjes është dëshmi, që personi nuk i nënshtrohet sigurimit të detyrueshëm të shtetit tjetër kontraktues. Agjencia kompetente do të dërgojë një kopje të kësaj çertifikate tek personi, i cili është subjekt i kërkesës dhe tek punëdhënësi i atij personi apo personit të vetëpunësuar, i cili është subjekt i kërkesës.

2. Çertifikata e mbulimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, lëshohet:
Për Republikën e Shqipërisë, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.
Për Republikën e Kosovës, nga Divizioni i Pensioneve të Jashtme.

3. Agjencia kompetente që ka lëshuar çertifikatën mund të vendosë ta revokojë atë. Në këtë rast, ajo duhet të njoftojë për këtë veprim agjencinë kompetente të shtetit tjetër kontraktues.

4. Kërkesa për zgjatjen e periudhës së dërgimit përtej dy viteve të parashikuara në marrëveshje, duhet të dorëzohet përpara skadimit të afatit të çertifikatës pranë autoritetit kompetent të shtetit kontraktues, nga territori i të cilit është dërguar personi. Nëse ky autoritet e pranon kërkesën, atëherë ai e dakordëson përmes komunikimit të shkruar me autoritetin kompetent të shtetit tjetër kontraktues, si dhe njofton personin aplikues dhe institucionet kompetente të shtetit të tij mbi vendimin.

PJESA E TRETË

DISPOZITA TË VEÇANTA NË LIDHJE ME PËRFITIMET

Neni 6
Përpunimi i një kërkese

1. Personat të cilët jetojnë në Kosovë dhe paraqesin kërkesë për përfitim në bazë të nenit 2 të Marrëveshjes sipas legjislacionit shqiptar, kërkesën e tyre e dërgojnë drejtpërdrejtë tek Divizioni i Pensioneve të Jashtme në Kosovë. Divizioni i Pensioneve të Jashtme, vendos në formular datën e dorëzimit të kërkesës, verifikon nëse kërkesa është e plotë, kontrollon nëse të gjitha dokumentacionet përkatëse për identifikimin dhe dokumentet e tjera zyrtare janë të bashkëngjitura dhe vërteton vlefshmërinë e dokumenteve zyrtare të bashkëngjitura. Divizioni i Pensioneve të Jashtme më pas ia përcjell kërkesën pa vonesë, kopjet e dokumenteve identifikuese dhe dokumentacionin zyrtar të bashkëngjitur si dhe formularët përkatës të periudhës së sigurimit, Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Instituti i Sigurimeve Shoqërore mund të kërkojë nga Divizioni i Pensioneve të Jashtme ose drejtpërdrejtë nga personi që ka paraqitur kërkesën ose tek punëdhënësi, vërtetime dhe informacione shtesë në mënyrë që të sigurojë këto të dhëna.

2. Personat të cilët jetojnë në Shqipëri e paraqesin kërkesën për pension në bazë të nenit 2 të Marrëveshjes sipas legjislacionit të Kosovës drejtpërdrejtë tek Instituti i Sigurimeve Shoqërore në Shqipëri. Instituti i Sigurimeve Shoqërore vendos në formular datën e paraqitjes së kërkesës, verifikon nëse kërkesa është e plotë, kontrollon nëse të gjitha dokumentacionet përkatëse për identifikimin dhe dokumentet e tjera zyrtare janë të bashkëngjitura dhe vërteton vlefshmërinë e dokumenteve zyrtare të bashkëngjitura. Më pas ai dërgon kërkesën pa vonesë, kopjet e dokumentacioneve identifikuese dhe të dokumentacioneve zyrtare të bashkëngjitura si dhe formularët përkatës të periudhave të sigurimit tek Divizioni i Pensioneve të Jashtme. Divizioni i Pensioneve të Jashtme mund të kërkojë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore ose drejtëpërdrejtë nga personi që paraqet kërkesën ose tek punëdhënësi, vërtetime dhe informacione shtesë.

3. Përjashtimisht nga paragrafi (1) dhe (2) i këtij neni, personat mund ta dorëzojnë kërkesën e tyre edhe direkt tek agjencitë kompetente të shteteve kontraktuese.

4. Personat, të cilët jetojnë në një shtet të tretë dhe kërkojnë përfitime sipas legjislacionit të Shqipërisë apo sipas legjislacionit të Kosovës, i drejtohen drejtpërdrejtë agjencisë kompetente.

PJESA E KATËRT

DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 7
Shkëmbimi i statistikave

Zyrat ndërlidhëse të të dy shteteve kontraktuese për çdo vit kalendarik i përcjellin njëra-tjetrës statistika mbi personat e dërguar dhe pagesat për përfituesit në zbatim të marrëveshjes. Statistikat përmbajnë, të ndara sipas llojit të përfitimeve, numrin e përfituesve dhe shumën totale të përfitimeve të paguara.

Neni 8
Dokumentacioni mjekësor dhe kontrollet mjekësore

1. Agjencia kompetente e njërit shtet kontraktues i përcjell me kërkesë agjencisë kompetente të shtetit tjetër kontraktues, pa pagesë, të gjitha dokumentet mjekësore që ka në dispozicion në lidhje me invaliditetin e personit, i cili ka paraqitur kërkesën për përftim ose është aktualisht përfitues në shtetin tjetër kontraktues.

2. Kur paraqitet kërkesa për përfitim, agjencia kompetente e shtetit të vendbanimit të përhershëm i vë në dizpozicion pa pagesë agjencisë kompetente të shtetit tjetër kontraktues formularin e dakordësuar (raportin mjekësor).

Neni 9
Kontrolle mjekësore dhe informacione shtesë

1. Nëse një person, i cili ka aplikuar apo përfiton pension invaliditeti sipas legjislacionit të njërit shtet kontraktues, banon në territorin e shtetit tjetër kontraktues, atëherë agjencia kompetente në çdo kohë mund t'i kërkojë zyrës ndërlidhëse të këtij shteti kontraktues, të ndërmarrë kontrolle mjekësore ose të mbledhë informacione shtesë sipas legjislacionit të zbatueshëm për të. Agjencia kompetente e shtetit kontraktues ku banon personi, ka të drejtë të zgjedhë mjekun i cili do të kryejë kontrollin mbi personin që ka aplikuar apo është përfitues i një pensioni.

2. Nëse agjencia kompetente e një shteti kontraktues kërkon një raport mjekësor shtesë për një person i cili ka paraqitur kërkesë apo është përfitues i një pensioni, atëherë agjencia kompetente e shtetit tjetër kontraktues, kryen kontrollin e nevojshëm mjekësor në territorin në të cilin banon personi në fjalë, sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas tarifave të zbatueshme në shtetin ku banon personi.

3. Pas paraqitjes së një fature të detajuar me dokumentacionin justifikues, shpenzimet e përmendura në paragrafin 2, do të rimbursohen nga agjencia kompetente që ka kërkuar kontrollin. Detajet e procedurave të rimbursimit do të përcaktohen nga zyrat ndërlidhëse në mirëkuptim të ndërsjelltë.

Neni 10
Ndihma administrative

1. Në përputhje me nenin 23 të Marrëveshjes dhe brenda afateve të legjislacionit të zbatueshëm, agjencia kompetente e një shteti kontraktues mund t'i dërgojë agjencisë kompetente të shtetit tjetër kontraktues kërkesa për informacion dhe verifikim, në veçanti, përsa i përket vdekjes së një personi. Nëse kjo agjenci e fundit ka akses në të dhënat e kërkuara, kjo agjenci do t'ia sigurojë ato agjencisë së parë.
2. Çdo informacion lidhur me të dhënat personale të një shtetasi që do të përcillet nga njëra agjenci ndërlidhëse tek tjetra, do të përdoret vetëm dhe eskluzivisht për qëllimet në zbatim të kësaj Marrëveshjeje.
3. Nëse shtetasi refuzon të japë një informacion të kërkuar rreth sigurimeve shoqërore sipas marrëveshjes, kërkesa e tij do të refuzohet.

Neni 11
Hyrja në Fuqi

1. Kjo Marrëveshje Administrative do të ketë efekt në datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes dhe mbetet e vlefshme për periudhën kur Marrëveshja mbetet në fuqi.

2. Autoritetet kompetente, me miratim të ndërsjelltë me shkrim, mund ta ndryshojnë këtë Marrëveshje Administrative.

NËNSHKRUAR në dy kopje në Prishtinë, sot në datën 20.06.2022 në gjuhën shqipe, ku secila kopje është njëlloj e vlefshme.

PËR AUTORITETIN KOMPETENT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	**PËR AUTORITETIN KOMPETENT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**